



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale



Nr. Prot.07/25

Datë: 5. 3. 2020

Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/56 të datës 27.02.2020, për të nxjerrë në diskutim publik **DRAFT-PROGRAMIN KOMUNAL PËR BANIM PËR PERIUdhËN 2020-2022**, sipas Neneve 12 pika (d), dhe 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040;Ligji Nr.03/L-164, dt.04.2010 për financimin e programeve të veçanta të banimit; Nenin 10.4 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, për Transparencë në Komuna Nr.04/2018; Udhëzimi Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna Nr.06/2018; Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 27. 2. 2020, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpall këtë:

NJOFTIM PËR DEBAT PUBLIK ME QYTETARË

DRAFT – PROGRAMIN KOMUNAL PËR BANIM PËR PERIUdhËN 2020-2022

Njoftojmë qytetarët e komunës së Shtimes, se Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27. 2. 2020 ka marrë vendim që të nxjerrë në Diskutim Publik:

DRAFT-PROGRAMIN KOMUNAL PËR BANIM PËR PERIUdhËN 2020-2022

Duke u bazuar në këtë vendim të Kuvendit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, organizon **Diskutimin Publik me Qytetarë**.

Debati me Qytetarë do të mbahet, më **20 mars 2020 (e premte)**, në ora **15:00**, në ndërtesën e Komunës së Shtimes, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Ftojme qytetarët e Komunës së Shtimes, përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës, shoqërinë civile dhe të tjerët që të kontribuojnë me pjesëmarrjen e tyre në këtë debat.

DRAFT - PROGRAMIN KOMUNAL PËR BANIM PËR PERIUdhËN 2020-2022, për Komunën e Shtimes mund ta shkarkoni nga uebfaqja zyrtare e komunës: kk.rks-gov.net/shtime ose mund ta merrni si kopje fizike në Zyrën për Informim.

Drejtor i drejtorisë, Labinot Beqa

